

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **611-26-1255-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Sigurimi i veturave të institucioneve të Komunes së Drenasit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	KOMPANIA E SIGURIMEVE " PRISIG " SH.A.
NUI	601173371
Adresa	Rr.Eduard Lir, Ob.2-Lagj.Arbëria
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	038 221 000
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Besarb Blakaj
Adresa elektronike	tenders@prisig-ks.com
Data e parashtrimit të ankesës	06.05.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Sigurimi i veturave të institucioneve të Komunes së Drenasit

Ne Kompania e Sigurimeve Prisig Sh.a, kemi marr pjese ne aktivitetin e prokurimit me titull: **Sigurimi i veturave të institucioneve të Komunes së Drenasit dhe me nr. te prokurimit: 611-26-1255-2-2-1, pas njoftimit per vendim te AK, ku ne PRISIG SH.A jemi shpallur ofertues te passukseshem nga aktiviteti I ketij Prokurimi ndersa OE Illyria eshte shpallur fitues, kur ne fakt ky OE ishte dashur te eliminohen nga ky aktivitet I prokurimit, jemi te obliguar qe te bejme kerkese per rishqyrtim pasi qe e shohim te arsyeshme duke u bazuar ne LPP.**

Pas pranimit te Njoftimit per Vendim nga AK, ne kemi kerkuar qasje ne dokumentet e OE Siguria dhe pas shqyrtimit te Pershkrimit te cmimeve te OE Illyria, kane bere shkelje te tarifave te vendosura nga Banka Qendrore e Kosoves e cila eshte edhe rregullatore dhe mbikqyrese e jona, per veturat me nr. rendor 18, 26 dhe 28.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Njoftimi për kontratë: 13.03.2026

Takimi per hapjen e tendereve: 06.04.2026

Procesverbali i hapjes se tenderve : 06.04.2026

Njoftimi per vendimin e AK : 28.04.2026

Kerkesa per Rishqyrtim: 30.04.2026

Pergjigja nga AK per kerkesen e rishqyrtimit: 04.05.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkelje e nenit 1 të LPP-së (Qëllimi)

Shkelje e nenit 6 të LPP-së (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)

Shkelje e nenit 7 të LPP-së (Barazia ne Trajtim/ Jo- Diskriminimi)

Shkelje e nenit 59 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Shkelje e nenit 60 të LPP-së (Kriteret për Dhënien e Kontratës).

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne Kompania e Sigurimeve Prisig Sh.a, kemi marr pjese ne aktivitetin e prokurimit me titull: Sigurimi i veturave të institucioneve të Komunes së Drenasit dhe me nr. te prokurimit: 611-26-1255-2-2-1, pas njoftimit per vendim te AK, ku ne PRISIG SH.A jemi shpallur ofertues te passukseshem nga aktiviteti I ketij Prokurimi ndersa OE Illyria eshte shpallur fitues, kur ne fakt ky OE ishte dashur te eleminohen nga ky aktivitet I prokurimit, jemi te obliguar qe te bejme kerkesa per rishqyrtim pasi qe e shohim te arsyeshme duke u bazuar ne LPP.

Pas pranimit te Njoftimit per Vendim nga AK, ne kemi kerkuar qasje ne dokumentet e OE

Siguria dhe pas shqyrtimit të Pershkrimit të cmimeve të OE Illyria, kanë bërë shkelje të tarifave të vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës e cila është edhe rregullatore dhe mbikqyrese e jona, për veturat me nr. rendor 18, 26 dhe 28

Shkeljet e evidentuara të automjetet me nr. rendor 18,26 dhe 28

Sistemi Insurex është platforma e sigurimeve TPL dhe TPL e cila përdoret nga të gjitha kompanit e sigurimeve, gjithashtu të gjitha kompanit e sigurimeve punojnë në bazë të tarifave të miratuara nga BQK – shih linkun e bashkangjitur. ([https://bqk-kos.org/mbikeqyrja-financiare/mbikeqyrja-e-sigurimeve/tarifat-dhe-buletini-statistikor/?selected_category=Tarifat e MTPL për të gjitha kompanitë e sigurimeve](https://bqk-kos.org/mbikeqyrja-financiare/mbikeqyrja-e-sigurimeve/tarifat-dhe-buletini-statistikor/?selected_category=Tarifat%20e%20MTPL)).

a. Përmes sistemit Insurex mund të bëhet verifikimi i cmimit për vetura, ku shihet qart që vetura me nr. rendor 18 Tojota është veturë e Grupit Tarifor I – Cm3, me shenimet teknike 2779cm³ me cmim 313.79€, ndërsa OE Illyria ka bërë shkelje të tarifave, ndryshim të kategorizimit dhe ka ofertuar cmim më të ulët që është 240.72€. (të bashkangjitur e gjëni edhe foton e cmimores së sistemit Insurex).

b. Përmes sistemit Insurex mund të bëhet verifikimi i cmimit për vetura, ku shihet qart që vetura me nr. rendor 26 Automjeti Peugeot është veturë e Grupit Tarifor II – Ton, me shenimet teknike 0.752Ton me cmim 198.24€, ndërsa OE Illyria ka bërë shkelje të tarifave, ndryshim të kategorizimit dhe ka ofertuar cmim më të ulët që është 137.47€. (të bashkangjitur e gjëni edhe foton e cmimores së sistemit Insurex).

c. Përmes sistemit Insurex mund të bëhet verifikimi i cmimit për vetura, ku shihet qart që vetura me nr. rendor 28 Automjeti Peugeot është veturë e Grupit Tarifor II – Ton, me shenimet teknike 1,010Ton me cmim 240.72€, ndërsa OE Illyria ka bërë shkelje të tarifave, duke demtuar buxhetin e shtetit të Republikës së Kosovës dhe ka ofertuar cmim më të lartë që është 299.72€. (të bashkangjitur e gjëni edhe foton e cmimores së sistemit Insurex).

Shkeljet e evidentuara: Lista e kontratave & Referencat

Pasi që kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e OE Illyria, kemi vërejtur që ka edhe shkelje të LPP, në dokumentacionin e ngarkuar.

OE Illyria ka ngarkuar një listë të kontratave nga një AK “Zyra e kryeministrit” dhe një OE “Swiss Corp SH.P.K”.

Kontrata me AK Zyra e Kryeministrit figuron me data 16.12.2020 – 15.12.2023 me nje reference te leshuar me daten 02.09.2024 e cila eshte leshuar per kontraten e skaduar si dhe per kontraten aktuale. AK ne asnje moment nuk mund te leshoj reference per kontrata active dhe qe nuk kan mbaruar, qe do te thot se referenca per kontraten e periudhes 22.12.2023-21.12.2026 nuk eshte valide. Kur ju si AK me daten 15.04.2026 I keni kerkuar qe tua prezantojne kontratat per referencat e prezantuara, OE Illyria ka prezantuar kontraten e re e cila eshte ende ne proces, ndersa te dosja e tenderit pika III.2.4 Kapaciteti teknik dhe professional, thuhet qarte qe “ **Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte të ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 14,000.00 €.**”, ky kriter nuk eshte permbushur nga ana e OE Illyria dhe rrjedhimisht qon ne eliminimin e OE nga ana e AK, gje te cilen nuk e keni bere.

Gjithashtu OE Illyria ne listen e kontratave e ka te cekur nje kontrate per periudhen 2022-2024 me OE Swiss Corp SH.P.K si dhe nje reference te leshuar nga OE Swiss Corp me daten 08.01.2025 e cila nuk eshte e percjellur me deshmi te pagesave nga banka. Ne dosjen e tenderit specifikisht eshte e shenuar qarte, pika III.2.4 Kapaciteti Teknik dhe Professional, ““ **Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte të ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 14,000.00 €.**” – **Deshmia e kerkuar: Kur sherbimi eshte kryer per ndonje kompani private duhet te ofrohet edhe deshmia nga banka per ato referenca.** Ketu ju si AK eshte dashur ta eliminoni OE Illyria per mos permbushje te kriterëve te kapacitetit teknik dhe professional.

Ne vendimin e AK ne lidhje me kerkesen tone me rishqyrtim te dates 04.05.2026, AK ne menyre amatoreske ka kthyer nje pergjigje te pergjysmuar dhe si duket nuk ka marr mundin as te lexoje ankesen tone deri ne fund, pasi qe pergjigje e tyre eshte absurde. Vendimi i Autoritetit Kontraktues është në kundërshtim të plotë me nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik, pasi nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm dhe nuk trajton në mënyrë individuale pretendimet konkrete të paraqitura nga operatori ekonomik ankues. Mungesa e analizës konkrete përbën shkelje të parimit të transparencës dhe llogaridhënies. Autoriteti Kontraktues ka dështuar të zbatojë nenin 59 të LPP-së, pasi nuk ka bërë ekzaminim, vlerësim dhe krahasim të drejtë të ofertave. Pranimi i një oferte që devijon nga tarifat e detyrueshme të Bankës Qendrore të Kosovës përbën shkelje serioze procedurale dhe materiale.

Pergjigja e AK si vijon “ Autoriteti Kontraktues ka analizuar kerkesen tuaj per rishqyrtim dhe pretendimet e paraqitura nga ana e juaj te pabazuara pasi qe tarifat jane konform BQK kjo eshte vertetuar dhe nga komisioni I vleresimit I cili ka analizuar qmimet sipas listes se

BQK. Dhe kjo deshmohet dhe ne kerkesen per rishqyrtim ku keni paraqitur cmimet per te gjitha kompanit”, por verehet qarte qe AK nuk I ka verifikuar cmimet, pasi ne kerkesen tone per rishqyrtim kemi bashkangjitur faktet e palekundshme te cilat deshmojne se OE Illyria ka bere shkelje te tarifave dhe manipulim te cmimit. Duke u bazuar edhe ne librezat e veturave te cilat I ka bashkangjitur ne dosje te tenderit AK, si dhe shenimeve ne systemin Insurex ku jane te regjistruara veturat e AK, vertetohen cmimet te cilat jane ofruar nga ana e jone te cilat jane cmimet reale. OE Illyria nese ka pasur diqka te paqarte ka mundur te paraqet kerkese per informata shtese. Tarifat e BQK për sigurimet TPL janë të detyrueshme dhe çdo devijim nga këto tarifa përbën ofertë të papërgjegjshme. Përdorimi i kategorizimit të gabuar për qëllim të uljes së çmimit përbën manipulim të ofertës dhe cenim të konkurrencës së ndershme. Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete nga sistemi INSUREX për të kundërshtuar gjetjet tona, duke lënë të paargumentuar pranimin e ofertës së operatorit ekonomik të shpallur fitues. Pranimi i ofertave që nuk respektojnë tarifën e BQK dëmton drejtpërdrejt interesin publik, deformon tregun e sigurimeve dhe krijon precedent të rrezikshëm për praktikën e ardhshme të prokurimit publik.

Gjithashtu nuk nga ana e AK nuk janë marrë parasysh faktet e tjera të ofruara nga ana e jone në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga OE Illyria, si dhe nuk ka kthyer përgjigje fare në kërkesën tonë për rishqyrtim në lidhje me pretendimet e tona për shkelje të dispozitave të LPP. Edhe këtu AK ka bërë shkelje të rënda duke i anashkaluar të gjitha Nenet e LPP, mbi të gjitha I ka anashkaluar edhe kërkesat minimale të cilat vet I ka vendosur në dosje të tenderit sic janë “ **Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte të ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 14,000.00 €.**” – **Deshmia e kerkuar: Kur shërbimi është kryer për ndonjë kompani private duhet të ofrohet edhe dëshmia nga banka për ato referenca.**”, ashtu sic I kemi sqaruar edhe më lart.

Sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional, operatori ekonomik i shpallur fitues nuk i përmbush kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit. Referencat e paraqitura për kontrata aktive janë të pavlefshme, ndërsa mungesa e dëshmisë bankare për kontrata private përbën mosplotësim të qartë të kriterit, i cili duhet të rezultonte me eliminim automatik nga procedura.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40 të RRPP Nr.001/2022, kurse njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, ndërsa paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që “Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse”,

Po ashtu, autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga AK që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e **OE “KOMPANIA E SIGURIMEVE PRISIG SH.A”** si e bazuar,

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet ne fitimin e humbur dhe demtim te emrit dhe reputacionit ne tregun e sigurimeve

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*